



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 773/10 prot.

Datë 22/05/2024

**V E N D I M**  
**Nr. 553/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22/05/2024, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “NISATEL” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-92085-12-26-2023, me objekt: “Shërbim internet për nevoja të SHRUKD”, me fond limit 2,900,000 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 08.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.

**Ankimues:** Operatori Ekonomik “NISATEL” SHPK, me NIPT: K26330201T.  
Adresa: *Lagjia “Pavarësia”, Rruga “Pelivan Leskaj”, Rrethi Skelë, Kulla e I, Kati i II, Vlorë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.  
Adresa: *L.17 Rr. Dalip Peza, Durrës.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

*Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.12.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-92085-12-26-2023, me objekt: “*Shërbim internet për nevoja të SHRUKD*”, me fond limit 2,900,000 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 08.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.

II.2. Në datë 12.02.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 19.02.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “iCom” SHPK	00 leke	skualifikuar
2. “NISATEL” SHPK	1,888,000 leke	skualifikuar
3. “Albanian Satellite Communications” SHPK	2,711,400 leke	kualifikuar

II.4. Në datën 19.02.2024, operatori ekonomik “NISATEL” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

*“Operatori ekonomik nuk permbush:*

*PIKEN GJ) Oferta ekonomike.. Operatori nuk ka ngarkuar listën e detajuar të çmimeve për shërbimet e kërkuara në tabelën përkatëse të shërbimeve.*

*Piken 2.3.3 Aftesitë teknike dhe profesionale “Operatori ekonomik nuk ka paraqitur lejen e përdorimit të frekuencave nga AKEP”.*

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet se më datën 29.03.2024 autoriteti kontraktor publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “Albanian Satellite Communication” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 03.04.2024 është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3938 dhe me nr. 773 protokollit datë 03.04.2024 e operatorit ekonomik “NISATEL” SHPK paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht paraqitur pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 773/3, datë 04.04.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NISATEL” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 10/32 prot, datë 05.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 773/4 prot datë 08.04.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “NISATEL” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.8. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor, rezulton se ky i fundit me shkresën nr. 10/32 prot, datë 05.04.2024, ka vendosur:

*“ [...] Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik Nisatel shpk, pasi nuk ka zbatuar afatet e parashikuara në LPP dhe VKM [...]”.*

II.9. Me shkresën nr. 773/5 prot., datë 03.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik ka vënë në dijeni autoriteti kontraktor, operatorin ekonomik ankimues dhe palët e interesuara se për një shqyrtim sa më të drejtë, transparent dhe objektiv të ankesës ka kërkuar informacion shtesë,

dhe verifikim nga palë të treta (subjekte private/huaja, kombëtare/ndërkombëtare), dhe në referim të nenit 115 pika 5 e ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, afatet për shqyrtimin e ankesës nr. 773 prot, datë 03.04.2024 do të ndërpriten deri në mbërritjen e informacionit të kërkuar.

II.10. Me shkresën nr. 773/6 prot., datë 03.05.2024, me objekt “Kërkesë për Informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, nga e cila kërkon informacion si më poshtë vijon:

*“Komisioni i Prokurimit Publik është duke shqyrtuar një ankesë të paraqitur nga një operator ekonomik, për një procedurë prokurimi me objekt “Shërbim internet për nevoja të SHRUKD”.*

*Për një shqyrtim sa më të drejtë të çështjes objekt-ankimi, kërkojmë nga ana juaj si institucion, të na informoni nëse operatori ekonomik “NISATEL” SHPK, me NIPT: K26330201T është i pajisur me licencën për trasmetim të dhënash dhe lejen e përdorimit të frekuencave sipas specifikimeve teknike bashkëlidhur dhe nëse këto lloje licensash lëshohen nëse nuk janë dhënë pikat e specifikuara ku do të bëhen lidhjet.*

*Për vetë rëndësinë, që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, lutemi të na dërgoni kthim përgjigje.”*

II.11. Me datë 13.05.2024 është depozituar shkresa me nr. 1225/1 prot., datë 13.05.2024 e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, protokolluar me tonën me nr. 773/7 prot., datë 15.05.2024 me përmbajtje si më poshtë vijon:

*“Sipërmarrësi NISATEL sh.p.k, me NIPT K26330201T, është regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe është pajisur nga AKEP me Çertifikatën e përditësuar të Konfirmimit të Njoftimit nr. 2023-AP-1.1\_756 datë 12.03.2024, Ky sipërmarrës ka të drejtë të ofrojë rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike, përfshirë shërbimet transmetim të dhënash, internet, telefoni fikse, etj. Rrjetet, shërbimet dhe zonat e rrjetit/shërbimeve (bashkitë/njësitë administrative) të njoftuara nga ky sipërmarrës, janë të shënuara në çertifikatën e lëshuar nga AKEP.*

*Lidhur me përdorimin e frekuencave, sqarojmë se sipërmarrësit kanë të drejtë të përdorin disa lloje frekuencash, por vetëm pasi të jenë pajisur me autorizim individual nga AKEP.*

*Sipërmarrësi NISATEL sh.p.k nuk disponon autorizim individual për përdorim frekuencash, por bazuar në nenin 67, të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe Rregulloren e AKEP nr. 30/2013 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, ky sipërmarrës, në çdo kohë, ka të drejtë të aplikojë për pajisje me autorizim individual për përdorim frekuencash, duke paraqitur aplikimin nëpërmjet sistemit online të AKEP.*

*Gjithashtu, sqarojmë se bazuar në pikën 5, të nenit 65, të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe rregulloren e AKEP nr. 30/2013 “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, sipërmarrësit e regjistruar në AKEP, për ofrimin e shërbimeve, mund të përdorin disa frekuenca pa autorizim individual, të përcaktuara në këtë rregullore, duke respektuar kriteret teknike, por duke i regjistruar antenat në AKEP, përpara fillimit të operimit të tyre.”*

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “NISATEL” SHPK për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “*Piken 2.3.3 Aftësitë teknike dhe profesionale “Operatori ekonomik nuk ka paraqitur lejen e përdorimit të frekuencave nga AKEP”.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.3 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

**2.3.2.** “*Operatori ekonomik të paraqesë Liçencë të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për transmetim të dhënash si dhe lejen e përdorimit të frekuencave të licencuara nga AKEP qe do të përdoren sipas specifikimeve teknike.*”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “NISATEL” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri.

III.1.3. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit nr.162/2022 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Neni 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr.162/2022 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar parashikohet se: “*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*”

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.7. Në nenin 41, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të

refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçencë të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për transmetim të dhënash si dhe lejen e përdorimit të frekuencave të licencuara nga AKEP, për këtë procedurë prokurimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “NISATEL” SHPK, konstatohet se ky i fundit nuk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike asnjë Liçencë. Komisioni i Prokurimit Publik, duke marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues thema decidendum, konstaton se arsyeja e skualifikimit lidhet me mosparaqitjen e Liçencës të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për transmetim të dhënash si dhe lejen e përdorimit të frekuencave të licencuara nga AKEP.

Referuar arsyes se skualifikimit Komisioni Prokurimit Publik duke qenë se ndodhet përpara faktit të disponimit të një liçense të lëshuar nga një autoritet kompetent shtetëror për një gjykim të drejtë dhe transparent ju drejtua zyrtarisht Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare me shkresën nr. 773/6 prot., datë 03.05.2024.

Në përgjigje të kërkesës së KPP-së, në datën 15.05.2024 është protokolluar me nr. 773/7, shkresa me nr. 1225/1 prot., datë 13.05.2024 nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, sipas të cilit Komisioni i Prokurimit Publik informohet se: “Sipërmarrësi NISATEL sh.p.k nuk disponon autorizim individual për përdorim frekuencash, por bazuar në nenin 67, të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe Rregulloren e AKEP nr. 30/2013 “Për dhënien e



*autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”, ky sipërmarrës, në çdo kohë, ka të drejtë të aplikojë për pajisje me autorizim individual për përdorim frekuencash, duke paraqitur aplikimin nëpërmjet sistemit online të AKEP.”.*

Duke marrë shkas nga kthim përgjigjia e sipërcituar administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes në gjykojmë se me operatori ekonomik “NISATEL” SHPK nuk e përmbush kriterin e përcaktuar në pika 2.3.3 “*Aftësia teknike dhe profesionale*”, të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, për faktin se Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në korespondencën që ka patur me Komision thekson se operatori ekonomik “NISATEL” SHPK nuk disponon autorizim individual për përdorim frekuencash. Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “NISATEL” SHPK nuk e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit “*Aftësia teknike dhe profesionale*” të dokumentave të tenderit.

Pretendimi i operatorit ekonomik “NISATEL” SHPK nuk qendron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “NISATEL” SHPK për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “*Operatori ekonomik nuk përmbush:*

*PIKEN GJ) Oferta ekonomike.. Operatori nuk ka ngarkuar listën e detajuar të çmimeve për shërbimet e kërkuara në tabelën përkatëse të shërbimeve”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 1 “*FORMULARI I OFERTËS*”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

“

Shtojca 1.

*(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### **FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat

specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*].

(c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor [**vendos emrin e Autoritetit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për [**vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE**] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

III.2.2. Në shtojcën 2 “*LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE*”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

“

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**  
(në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njësi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
<b>Çmimi total (Mallrat)</b>					_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

III.2.3. Në shtojcën 6 “*FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT*”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

**“Shtojca 6**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “Shërbim internet për nevoja te SHRUKD”**

**Afatet e ekzekutimit:** Afati i shërbimit do të jetë 12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.

Shërbimet (shërbim interneti)			Përshkrimi i shërbimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Nr.	Qendra	Adresa				
1	UKD Zyra qendrore	L.17	300 Mbits CIR 100 Mbits Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
2	UKD 1	L.11	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
3	UKD 2	L.12	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
4	UKD 3 ITUND Shenavlash	Shenevlash tregu makina ve	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
5	UKD 4	Shijak	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
6	UKD 5	Shijak	50Mbits CIR 10 Mbits Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.

7	UKD 6	L.4	50Mbps CIR 10 Mbps Internet I dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
8	UKD 7	Sukth	50Mbps CIR 10 Mbps Internet I dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
9	UKD 8	Manze	50Mbps CIR 10 Mbps Internet I dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
10	UKD Pompa Nr.9	Kenete	30Mbps Data e dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
11	UKD Pompa Nr.6	L.17, drini	30Mbps Data e dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
12	UKD Pompa Nr.5	L.13, rrota kuqe	30Mbps Data e dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
13	UKD Pompa Nr.4	L.13, Florida tregu	30Mbps Data e dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
14	UKD Pompa Nr.2	Plepa, blloku	30Mbps Data e dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
15	UKD Pompa Nr. 1.1	Gole prane hotel kamelia	30Mbps Data e dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
16	UKD Pompa Nr. 1.2	Shkem bi I Kavajes	30Mbps Data e dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
17	UKD Pompa Nr.	Shkem bi I	30Mbps Data e dedikuar simetrik	Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas

	1.3	Kavajes , afer Majestic				nënshkrimi të planit të zbatimit të kontratës.
18	UKD Pompa Nr.8	L.13, Teuta	30Mbps Data e dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimi të planit të zbatimit të kontratës.
19	UKD Pompa Tropikal	Plepa, kompleksi Tropikal	30Mbps Data e dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimi të planit të zbatimit të kontratës.
20	UKD Pompa Xhafzotaj	Xhafzotaj	30Mbps Data e dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimi të planit të zbatimit të kontratës.
21	UKD Zyra qendrore	Durres L.17	100 Mbps Internet per Backup		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimi të planit të zbatimit të kontratës.
22	Zyre xhafzotaj	Xhafzotaj	30Mbps Data e dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimi të planit të zbatimit të kontratës.
23	ITUND Gjiri Lalzit	Gjiri Lalzit( Hamallaj)	50Mbps CIR 10 Mbps Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimi të planit të zbatimit të kontratës.
24	ITUND Kavaje	Kavaj Synej	50Mbps CIR 10 Mbps Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimi të planit të zbatimit të kontratës.
25	UKD Pompa Nr.7 sp7	hysen kertusha ish urt	30Mbps Data e dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimi të planit të zbatimit të kontratës.
26	UKD Pompa Nr.8 sp8	vollga tek portside	30Mbps Data e dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimi të planit të zbatimit të kontratës.
27	zyrat Qendore Kruje	Kruje,B ARABIT	50Mbps CIR 10 Mbps Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimi të planit të

						zbatimit të kontratës.
28	Zyrat	Kavaj	100Mbps CIR 10 Mbites Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
29	UKK arke	Kavaj qender	50Mbps CIR 10 Mbites Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
30	zyrat qendrore Rrogozhine	Rrogozhine	50Mbps CIR 10 Mbites Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
31	UKD Zyra qendrore	L.17	4 ip publike statike		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
32	UKD Fush Kruje	Fush Kruje	50Mbps CIR 10 Mbites Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
33	UKD GOLEM	GOLEM KAVAJE	50Mbps CIR 10 Mbites Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
34	UKD Mali I Robit	Mali I Robit	50Mbps CIR 10 Mbites Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.
35	Kruje Bashkia	Kruje / Bashkia	50Mbps CIR 10 Mbites Internet I dedikuar simetrik		Sipas adresave	12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “NISATEL” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri sa i përket listës së detajuar të çmimeve si më poshtë:

“Lista\_e\_cmimeve.pdf”

III.2.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.6. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.



*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë Listën e çmimeve të shërbimeve të detajuar referuar edhe shtojcës 6 të dokumentave të tenderit, për këtë procedurë prokurimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “NISATEL” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dokumentin lista e çmimeve. Komisioni i Prokurimit Publik, duke marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues thema decidendum, konstaton se arsyeja e skualifikimit lidhet me mosparaqitjen e listës së çmimeve të detajuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem rezulton se operatori ekonomik “NISATEL” SHPK ka paraqitur dokumentin e emërtuar “Lista\_e\_cmimeve.pdf”, por në përmbajtje të tij nuk ka një listë të detajuar të ofertës sipas formatit të kërkuar në DST dhe konkretisht Shtojca 2.

Pretendimi i operatorit ekonomik “NISATEL” SHPK nuk qendron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “NISATEL” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-92085-12-26-2023, me objekt: “Shërbim internet për nevoja të SHRUKD”, me fond limit 2,900,000 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 08.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NISATEL” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**